

Informacion i rëndësishëm për ty që do të aplikosh për patentë shoferi për automobil:

Fillon të praktikohet Provimi i kombinuar për patentë shoferi të kategorisë B

Prej datës 1 Shtator 2008 provimi i njohurive teorike dhe i ngasjes për patentën e shoferit (kategoria B) konsiderohet si provim shoferi i kombinuar. Oë të dy provimet do të bëhen në kohë të përafërt me njëra-tjetrën, në të njejtën ditë apo brënda dy javësh. Provimi i ri i kombinuar për shoferë nënkupton se ti në të njejtin rast e cakton terminin për të dy provimet.

KËSHTU FUNKSIONON PROVIMI I KOMBINUAR PËR KATEGORINË B

- Prej datës 1 Shtator 2008 provimi i njohurive teorike dhe provimi i ngasjes bëhen në kohë të përafërt me njëra-tjetrën, në të njejtën ditë apo brënda dy javësh
- Provimi i njohurive teorike duhet të bëhet i pari
- Provimi i ngasjes duhet të bëhet pa marrë parasysh rezultatin e provimit të njohurive teorike
- Një provim i aprovuar i njohurive teorike- apo ngasjes ka vlefshmëri ligjore dy muaj
- Oë të dy provimet duhet të kalohen brënda dy muajsh, përndryshe duhet të paguhen tarifat e reja si dhe të ripërsëriten të dy provimet
- Nëse nuk e kalon provimin e njohurive teorike- apo të ngasjes të ofrohet termini i riprovimit brënda afatit të validitetit prej dy muajsh. Kjo vlenë nëse që të dy provimet janë zhvilluar brënda një periudhe prej dy javësh dhe nëse termini për riprovim caktohet më së voni tri ditë pas provimit të ngasjes. Riprovimi mund të rezervohet vetëm pasi të jenë kryer edhe provimi i njohurive teorike edhe ai i ngasjes.
- Prej datës 1 Shtator trajnimi për rreziqet duhet të jetë i kryer dhe i aprovuar para kryerjes së provimit të njohurive teorike dhe provimit të ngasjes
- Termimi për provimin e njohurive teorike dhe të ngasjes rezervohet njëkohësisht, duke filluar nga data 2 Qershor
- Rezervimi bëhet më së lehti përmes Internetit, në www.korkortsportalen.se. Gjithashtu mund ta kontaktosh shërbimin për konsumatorë për çështje të patentës për shoferë të Entit rrugor në numrin 0771-17 18 19. Nëse shkollohesh përmes autoshkollës rezervimi mund të bëhet përmes autoshkollës.
- Kur rezervon termin për herë të parë ke përparësi në të gjitha zyrat- dhe pikat e pranimit. Zyret e Entit rrugor të ofrojnë termin brënda tri javësh.

PSE FILLON TË PRAKTIKOHET PROVIMI I KOMBINUAR PËR KATEGORINË B?

Duhet të jetë thjeshtë për ta planifikuar dhe realizuar provimin e njohurive teorike- dhe provimin e ngasjes në mënyrë që të mund ta kesh patentën e shoferit në një kohë të caktuar. Planprogrami thekson rëndësinë e lidhshmërisë mes teorisë dhe praktikës dhe kjo duhet të pasqyrohet në provim. Kjo do të kontribuojë që numri i provimeve të aprovuara në tentimin e parë të rritet. Gjithashtu do të krijojë parakushte më të mira për të bërë shoferë më të sigurtë, më të vetëdijshëm për rreziqet dhe ambientin në frymën e Vizionit zero.

Eja i përgaditur mirë! Kjo do ti shtojë gjasat për ta kaluar provimin për patentë shoferi.

INFORMATA MË TË HOLLËSISHME

Lexo më shumë në portalin për patentë shoferi (Körkortsportalen): www.korkortsportalen.se apo kontaktoje Shërbimin për konsumatorë për çështje të patentës për shoferë në numrin 0771-17 18 19.